



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

**Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
500 tonelatë kripë për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dimrit**

10 tetor 2012, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e Komunës së Prizrenit" gjatë kësaj jave ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar disa konkluzione.

Qeveria komunale e Prizrenit ka miratuar propozimin e DSHP-së për shpalljen e tenderit për furnizim me kripë industriale për rrugë, në sasinë prej 500 tonelatash, që do të shërbejnë për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në qytet dhe në fshatra. Po ashtu duke u bazuar në kërkesat e banorëve të fshatit Zhur ekzekutivi lokal ka miratuar konkluzionin për shpalljen e tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale në këtë fshat me sistem të participimit (rruga: "Susuri", "Badallaj I dhe II", "Elezkurtaj" dhe rruga e "Badallajve" te varrezat.

Në këtë takim Drejtorja e Administratës ka marrë pëlqimin për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e sistemit të ngrohjes qendrore në objektin e Administratës komunale (parallogaria 14 mijë euro). Është miratuar edhe kërkesa tjetër e DA-së për blerjen e një automjeti "pick-up" Mirëpo në këtë takim ka pasuar edhe kërkesa e Drejtorisë së Katastrit dhe të Urbanizmit për blerjen edhe të një automjeti , që do të shërbej për nevojat e komunës. DA do të punësoj për 10 ditë me gjysmë orari pune pesë Persona me Aftësi të Kufizuara për nder të muajit të PAK-ve.

Në mesin e propozimeve të miratuara të Drejtorisë së Turizmit dhe të Zhvillimit Ekonomik veçohen: lejimi i shpalljes së tenderit për rregullimin e oborrit të ndërtesës së "Beledijes", lejimi i shpalljes së tenderit për rregullimin e hapësirës te stacioni i autobusëve në lagjen "Ralin" si dhe lejimi i shpalljes së tenderit për botimin e katalogut kulturor "Prizreni, vendtakim i civilizimeve".

Ndërsa Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës i është lejuar procedimi i tenderit për izolimin e konstruksionit meskatësh në SHMM "Lorenc Antoni" dhe lejimi i mjeteve shtesë në projektin e ndërtimit të rrethojës së oborrit të SHFMU "Lekë Dukagjini".

Në bazë të propozimit të nënkryetarit është formuar edhe komisioni për vlerësimin e asteve të dhuruara nga EULEX-i, sikurse është shqyrtuar edhe shpërndarja e shpenzimeve të telefonisë mobile në DA, DASH, dhe DSH.

Qeveria komunale ka mbështetur edhe OJQ-në "Gruaja Bashkëkohore" për realizimin e aktiviteteve të tyre, sikurse që ka ndarë mjete simbolike për mjekim të dy individëve që vuajnë nga sëmundjet malinje.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese

OJQ EC Ma Ndryshe

Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren

Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.